



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "VT-3" Sh.P.K. të datës 21.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "VT-3" Sh.P.K. të datës 21.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "VT-3" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 21.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“1. Kërkesa për 9 elektrikistë të certifikuar

Kërkesa që operatori ekonomik duhet të angazhojë 9 elektrikistë të certifikuar është joproportionale dhe e pajustificuar në raport me natyrën e kontratës.

Duke qenë se aktiviteti i kontratës është i karakterit mirëmbajtës, një kërkesë e tillë: tejkalon nevojat reale të projektit;

kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë;

krijon avantazh të padrejtë për operatorë të caktuar.

Një numër më i ulët i stafit profesional do të ishte i mjaftueshëm për realizimin e kontratës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Kërkesa për certifikim dhe përvojë 5-vjeçare

Kërkesa për një punëtor të certifikuar për menaxhimin e pikave matëse të energjisë elektrike me minimum 5 vite përvojë pune pas certifikimit është e pajustificuar dhe kufizuese.

Kjo për arsye se:

kontrata ka të bëjë me mirëmbajtje, jo me operim apo menaxhim kompleks të sistemeve;

niveli i kërkuar i specializimit nuk përputhet me natyrën e punëve;

kërkesa për përvojë 5-vjeçare është e tepruar dhe jo e arsyetuar.

Në përputhje me Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, kriteret duhet të jenë

proporcionale. Për këtë lloj shërbimi, një përvojë shumë më e shkurtër (p.sh. 1 vit përvojë relevante) është e mjaftueshme për të dëshmuar kapacitetin profesional.

Gjithashtu, kërkesa për certifikim specifik shtesë është e panevojshme, pasi:

këto punë mbulohen nga përgatitja profesionale e shkollave të mesme teknike;

aftësitë janë pjesë e kompetencave bazë të profesionit;

përvoja praktike është dëshmi e mjaftueshme.

Po ashtu, kufizimi që certifikata të jetë vetëm nga institucione të Kosovës ose të akredituara në Kosovë është diskriminues dhe përjashton kualifikimet ekuivalente”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se kërkesat për numër të mjaftueshëm të punëtorëve dhe kërkesat për licensa valide të njohura nga institucionet e shtetit të Kosovës janë absolutisht të domosdoshme për të garantuar se projekti do të realizohet në mënyrë efikase dhe efektive. Këto janë kërkesa bazike (themelore) të cilat si të tilla janë të domosdoshme për qëllimin që shërbejnë.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.